



## VENDIM

**Nr.105 Datë 17.10.2011**

### PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË "ERMA MP" SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma "a", të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma "a"; 5, pika 1, gërma "a", dhe neneve 13 dhe 14 pika 1, të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "ERMA MP" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë "ERMA MP" sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë "ERMA MP" sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec "Carshovë" me fuqi 1.5 MW, për një afat 30 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**  
Në mungesë dhe me porosi  
**Entela SHEHAJ**